



TË DREJTAT DHE DETYRIMET TUAJA GJATË PRITJES



Ky informacion është për ju në rast se:

- ✓ jeni nën 18 vjeç
- ✓ keni ardhur me njërin ose të dy prindërit
- ✓ ju dhe familja juaj keni bërë kërkesë për azil (që quhet edhe mbrojtje ndërkombëtare) në Irlandë

Ju dhe familja juaj jeni të sigurt në këtë vend	3
Kush mund t'ju ndihmojë?	3
Çfarë do të përfitoni ju dhe familja juaj?	4
E drejta për kujdes shëndetësor	6
Informimi i stafit	7
Çfarë është vlerësimi i interesit më të lartë?	8
E drejta për arsimim	8
E drejta për të punuar	9
Dokumenti juaj i azilkërkuesit	9
Ku do të qëndroni ju dhe familja juaj?	10
Si mund të veproni në rast se dikush ju trajton keq?	11
Çfarë detyrimesh keni ju dhe familja juaj gjatë pritjes?	12
Çfarë ndodh nëse ju dhe familja juaj nuk përmbushni detyrimet tuaja?	13
Rregullat për bërjen e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare dhe për udhëtimin drejt vendeve të BE+	14
Çfarë ndodh nëse ju dhe familja juaj largoheni drejt një prej vendeve të tjera?	15
Kush mund t'ju ndihmojë ju dhe familjen tuaj nëse nuk bini dakord me një vendim të marrë nga autoritetet?	16
Çfarë ndodh nëse ndryshon ndonjë aspekt i mbështetjes?	16
Të dhënat e kontaktit	17

➤ JU DHE FAMILJA JUAJ JENI TË SIGURT NË KËTË VEND

Ju dhe familja juaj jeni shprehur përpara autoriteteve se nuk mund të ktheheni në vendin tuaj, për shkak se ndodheni në rrezik dhe keni bërë kërkesë për azil. Ju dhe familja juaj jeni azilkërkues në Irlandë

➤ KUSH MUND T'JU NDIHMOJË?

Në Evropë, të gjithë personat nën 18 vjeç konsiderohen si fëmijë dhe kanë të drejtën të përfitojnë **mbështetje të posaçme**.

Gjatë qëndrimit brenda vendit, mund t'ju vijnë në ndihmë profesionistët e mëposhtëm:

- Një **punonjës social** do t'ju ndihmojë ju dhe familjen tuaj për nevojat e përditshme ose do të kontaktojë profesionistë të tjerë të cilët mund t'ju ndihmojnë për një problem konkret.
- Një **mjek** ose një **infermiere** do t'ju ndihmojë në rast se sëmureni ose lëndoheni apo nëse keni nevojë për çfarëdolloj ndihme mjekësore.
- Një **psikolog** do t'ju ndihmojë në rast se ndiheni të mërzitur, të zemëruar, të frikësuar ose të shqetësuar apo në rast se keni probleme me gjumin.
- Një **këshilltar ligjor** do t'ju ndihmojë ju dhe familjen tuaj të kuptoni se çfarë do të ndodhë gjatë procedurës së azilit dhe në rast se mendoni se të drejtat tuaja nuk janë respektuar.
- Një **përkthyes** mund t'ju ndihmojë të komunikoni në një gjuhë që e kuptoni. Përkthyesi ka për detyrë të përkthejë saktësisht ato që thoni ju dhe të tjerët.




Keni ndonjë problem? Mund t'i kërkonit në çdo kohë ndihmë dhe mbështetje stafit. Mos kini frikë, problemet mund t'i zgjidhim së bashku!

➤ ÇFARË DO TË PËRFITONI JU DHE FAMILJA JUAJ?

Ju do të përfitoni lloje të ndryshme mbështetjeje ndërkohë që prisni që autoritetet të shqyrtojnë kërkesën tuaj për azil. Kjo quhet **pritje**.

Si fëmijë dhe si azilkërkues, ju keni të drejta, por edhe detyrime që duhet t'i respektoni. Ato shpjegohen në këtë broshurë.

Nëse nuk i kuptoni pjesë të kësaj broshure ose nëse keni ndonjë pyetje, pyesni stafin në Qendrën e Pritjes Citywest dhe prindërit tuaj.



Gjatë qëndrimit tuaj në këtë vend, stafi do t'ju japë informacione të mëtejshme në varësi të situatës suaj. Ju mund të bëni pyetje në çdo kohë.

Në varësi të situatës suaj, ju dhe familja juaj do të përfitoni:



- një vend për të fjetur



- ushqim



- veshmbathje



- produkte të higjienës personale



- Familja juaj mund të përfitojë gjithashtu para për shpenzimet e përditshme.

E DREJTA PËR KUJDES SHËNDETËSOR

Autoritetet do të sigurohen që ju të merrni kujdesin shëndetësor që ju nevojitet.

Ju mund të njoftoni familjen tuaj dhe stafin për çdo problem shëndetësor që keni. Ata do t'ju ndihmojnë të vizitoheni pranë një infermieri ose mjeku nëse është nevoja.



Nëse mjeku e gjykon të nevojshme, ai do t'ju rekomandojë mjekime, si dhe vizita pranë specialistëve.

Ata do të kontrollojnë shëndetin tuaj dhe do t'ju ofrojnë ndihmën e nevojshme.

Stafi do t'ju tregojë juve dhe familjes suaj nës do t'ju duhet të bëni një kontroll mjekësor me një infermiere ose një mjek.

Nëse keni një emergjencë mjekësore ose një lëndim që kërkon trajtim të menjëhershëm, tregojuni prindërve ose stafit. Nëse ndodheni jashtë vendit ku po qëndroni, mund të telefononi pa pagesë në numrin e emergjencave 112 ose 999

▶ NJOFTONI STAFIN NË RAST SE:



- nuk ndiheni mirë, keni pësuar ndonjë lëndim apo ju nevojitet ndihmë mjekësore apo mjekim urgjent
- përdorni droga ose konsumoni alkool
- jeni përballur me dhunë ose abuzim në të kaluarën ose po përballeni tani
- jeni ose mund të jeni shtatzënë
- nuk ecni dot vetë ose keni vështirësi me dëgjimin apo shikimin
- jeni shumë të shqetësuar, të mërzhitur, nuk flini dot apo keni mendime negative
- ndiheni të pasigurt apo keni frikë nga dikush, qoftë i panjohur apo një person që e njihni
- ju kanë detyruar apo po ju detyrojnë të bëni gjëra kundër dëshirës suaj
- ndiheni të pasigurt për shkak të besimit tuaj, personit që doni, mënyrës sesi visheni apo silleni
- pjesëtarët e familjes suaj kanë nevojë për mbështetje.



▶ ÇFARË ËSHTË VLERËSIMI I INTERESIT MË TË LARTË?



Është një aktivitet ku do të takoni stafin tjetër që do t'ju bëjë pyetje për të:

kuptuar nevojat tuaja

vendosur se për çfarë mbështetjeje keni nevojë.

Kjo do t'i ndihmojë autoritetet të marrin vendime të rëndësishme, për shembull se ku do të qëndroni ju dhe familja juaj.

Kjo do t'i ndihmojë autoritetet të marrin vendime të rëndësishme, si për shembull ku do të qëndroni ju dhe familja juaj.

Ju mund të keni besim tek infermieri, mjeku dhe stafi. Mund të ndani gjithçka me ta. Asnjë nga gjërat që ju thonin nuk do të ndahet me persona të tjerë përveç prindërve tuaj pa pëlqimin tuaj. Përrashtim bëjnë vetëm rastet kur jeta juaj apo e dikujt tjetër është në rrezik.

▶ E DREJTA PËR ARSIM



Si fëmijë, ju keni të drejtën të arsimoheni dhe të mësoni. Nëse shkoni në shkollë dhe mbushni 18 vjeç gjatë kësaj kohe, mund të vazhdoni frekuentimin deri sa shkolla të përfundojë.

Stafi do t'ju ndihmojë ju dhe familjen tuaj të regjistroheni në shkollën lokale. Ata do t'ju informojnë rreth kurseve përgatitore të gjuhës dhe kurseve të tjera.

Stafi do t'ju informojë në lidhje me aktivitetet edukative dhe rekreative që do t'ju ndihmojnë të mësoni, të zhvilloheni dhe të bëni miq të rinj.

E DREJTA PËR TË PUNUAR



Në varësi të moshës dhe situatës suaj, mund t'ju lejohe të punoni në Irlandë, nëse dëshironi. Stafi në Qendrën tuaj të Akomodimit do t'ju japë më shumë informacion.

Nëse keni pritur një vendim të shkallës së parë për më shumë se 5 muaj dhe jeni 16 vjeç ose më i vjetër, mund të aplikoni për leje pune.



Të gjithë djemtë dhe vajzat nën 14 vjeç nuk lejohen të punojnë. Në Irlandë, mosha minimale për të punuar është 14 vjeç (për punë të lehta jashtë semestrit shkollor), por fëmijët nën 16 vjeç nuk mund të bëjnë punë të rregullta me kohë të plotë. Të rinjtë e moshës 16 dhe 17 vjeç mund të punojnë me kohë të plotë, por i nënshtrohen kufizimeve të rrepta ligjore për orët, pushimet dhe periudhat e pushimit ditor, javor dhe natën.

DOKUMENTI I AZILKËRKUESIT



Do të merrni një dokument personal ligjor me emrin dhe fotografinë tuaj. / Prindërit tuaj do të marrin një dokument personal me emrin dhe fotografinë tuaj.

Kjo tregon se jeni azilkërkues në këtë vend. Duhet ta mbani gjithmonë me vete. Mund ta ruani në telefonin tuaj, nëse keni një të tillë.

Ky dokument është i rëndësishëm, kini kujdes të mos e humbisni dhe mos ia jepni dikujt tjetër.

Ky dokument quhet Certifikatë Aplikanti për Mbrojtje Ndërkombëtare.

KU DO TË QËNDRONI JU DHE FAMILJA JUAJ?

Vendi ku do të qëndroni ndërkohë që autoritetet shqyrtojnë kërkesën tuaj për azil varet nga rrethanat tuaja.



Stafi i Shërbimit të Strehimit për Mbrojtje Ndërkombëtare do t'ju informojë se ku duhet të qëndroni të gjithë, për shembull në një strehim të caktuar ose në një qytet apo rajon të caktuar. Kjo mund të varet nga vendet e disponueshme ose nevojat e familjes suaj.

Nëse familja juaj dëshiron të qëndrojë jashtë akomodimit ose të largohet nga qyteti ose rajoni për një kohë të shkurtër, duhet të kërkojë leje nga autoritetet.

Ju dhe familja juaj mund të merrni mbështetje dhe shërbime vetëm në vendin e përcaktuar nga autoritetet.

Shumë rrallë, familjet mund të vendosen në një qendër ku nuk mund të hyjnë e të dalin sipas dëshirës. Nëse ndodheni në këtë situatë, do të asistoheni nga një këshilltar ligjor dhe nga stafi.

Pavarësisht vendit ku akomodoheni, ju keni të drejtën që:



- të qëndroni me familjen tuaj
- të kërkonin ndihmë për kërkimin e pjesëtarëve të familjes suaj, nëse nuk e dini se ku ndodhen.

Ju keni të drejtën të jeni të sigurt. Askujt nuk i lejohet:



t'ju kërcënojë



t'ju fyejë



t'ju lëndojë

Nuk ka rëndësi nëse bëhet fjalë për një të panjohur apo për një person që e njihni.


Nëse keni probleme me prindërit tuaj apo me stafin, mund ta ngrini zërin.

SI MUND TË VEPRONI NË RAST SE DIKUSH JU TRAJTON KEQ?



Mund të flisni me një person të cilit i besoni, një anëtar të familjes ose çdo anëtar të stafit në Qendrën e Akomodimit ose në Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare.

Nëse dikush ju trajton keq, ju mund ta raportoni këtë tek autoritetet për të shmangur përsëritjen e saj. Kjo quhet 'bërja e një ankese'.



Vëmendje!

Nëse ndodheni jashtë vendit ku po qëndroni dhe jeni në rrezik, mund të telefononi pa pagesë në numrin kombëtar të emergjencave 112 ose 999 nga çdo telefon.

➤ ÇFARË DETYRIMESH KENI JU DHE FAMILJA JUAJ GJATË PRITJES?

Është e rëndësishme që të tregoni të vërtetën dhe të bashkëpunoni me autoritetet, edhe nëse ndonjëherë ju duket e frikshme dhe e vështirë që të rrëfeni historinë tuaj.

Stafi mund t'ju vijë në ndihmë nëse ka dijeni për situatën tuaj.



Kudo që të qëndroni ju dhe familja juaj, do të ketë rregulla që duhen ndjekur. Për shembull, duhet të respektoni banorët e tjerë dhe stafin dhe nuk duhet të bëni zhurmë gjatë orëve të qeta.

Stafi do të shpjegojë rregullat dhe pasojat kur rregullat nuk respektohen.

Është shumë e rëndësishme që ju dhe familja juaj:

- ✔ të ndiqni rregullat e vendit ku po qëndroni
- ✗ të mos largoheni nga vendi ku autoritetet ju kanë thënë të qëndroni
- ✔ të respektoni ligjet e këtij vendi, të cilat do t'ju shpjegohen nga stafi.

➤ ÇFARË NDODH NËSE JU OSE FAMILJA JUAJ NUK PËRMBUSHNI DETYRIMET TUAJA?



Nëse kjo ndodh, mund të flisni hapur me stafin e Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare dhe të shpjegoni situatën tuaj dhe arsyet tuaja.

Autoritetet do ta vlerësojnë situatën dhe do të njoftojnë prindërit tuaj nëse vendosin të marrin masa.



Për shembull, nëse një pjesëtar i familjes suaj largohet nga qendra e akomodimit, qyteti apo rajoni ku autoritetet kanë vendosur se duhet të qëndrojë familja, **ai pjesëtar i familjes mund të përfitojë më pak mbështetje.**



Nëse një pjesëtar i familjes suaj sillet në mënyrë të dhunshme, **ai pjesëtar i familjes mund ta humbë mbështetjen që po përfiton.** Mund të thirret policia.

Tani, ju dhe familja juaj ndodheni në Irlandë , i cili është një vend i BE+. Vendet e BE+ janë:



27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE): Austria, Belgjika, Bullgaria, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Italia, Kroacia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Polonia, Portugalia, Qipro, Republika e Irlandës, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe



4 vende të tjera: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.

➤ RREGULLAT PËR BËRJEN E KËRKESËS PËR AZIL DHE PËR UDHËTIMIN DREJT VENDEVE TË BE+

Stafi i Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare do t'i shpjegojë këto rregulla të rëndësishme për ju dhe familjen tuaj. Ju mund të bëni pyetje në çdo kohë.

- ✔ Ju dhe familja juaj duhet të qëndroni në Irlandë dhe të mos largoheni drejt ndonjë prej vendeve të tjera të BE+ ose në Mbretërinë e Bashkuar (përfshirë Irlandën e Veriut).
- ✔ Nëse keni familjarë në ndonjë prej këtyre vendeve, autoritetet do t'ju informojnë në lidhje me të drejtat tuaja për bashkim familjar. Ju nuk mund thjesht të largoheni.




Mund të mendoni të largoheni nga ky vend ose disa njerëz do të përpiqen t'ju bindin të ikni. Mund të jetë e rrezikshme për ju. Ju dhe familja juaj mund të flisni me stafin në Qendrën tuaj të Akomodimit dhe t'u shpjegoni situatën. Stafi mund t'ju këshillojë.

- ✗ Nëse largoheni, do të përballeni me pasoja negative, të cilat shpjegohen në këtë broshurë. Për shembull, do të përfitoni më pak mbështetje gjatë pritjes në vendin tjetër.
- ✔ Mos harroni se duhet ta regjistroni kërkesën tuaj për azil në vendin e BE+ ku keni mbërritur fillimisht, me përjashtim të rastit kur autoritetet ju kanë informuar ndryshe.
- ✔ Vetëm një nga këto vende është përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesës suaj për azil. Autoritetet në Irlandë do t'ju informojnë cili është vendi përgjegjës për këtë.

Ju do të informoheni në lidhje me këto procedura në broshura të posaçme.

➤ ÇFARË NDODH NËSE JU DHE FAMILJA JUAJ LARGOHENI DREJT NJË PREJ VENDEVE TË BE+?



Në Irlandë procedura juaj e azilit mund të ndërpritet.

Në vendin tjetër të BE+:

- autoritetet mund të vendosin t'ju kthejnë në vendin e BE+ prej të cilit jeni larguar.

Nga momenti kur autoritetet ju njoftojnë në lidhje me vendimin e kthimit, ju nuk do të keni më akses në disa të drejta, si për shembull:

- nuk do të përfitoni disa lloje mbështetjeje dhe
- nuk do t'ju lejohet të punoni.

➤ KUSH MUND T'JU NDIHMOJË JU DHE FAMILJEN TUAJ NËSE NUK BINI DAKORD ME NJË VENDIM TË MARRË NGA AUTORITETET?



Ju mund të kërkonti ndihmën e një këshilltari ligjor. Këshilltari ligjor është një person që i njeh rregullat e këtij vendi dhe mund të analizojë situatën tuaj dhe t'ju vijë në ndihmë.

Stafi do t'ju informojë në lidhje me organizatat joqeveritare që mund t'ju japin gjithashtu informacione dhe ndihmë.



Ju mund të kontaktoni në çdo kohë Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). UNHCR mbron personat që janë detyruar të largohen nga vendi i tyre.

➤ ÇFARË NDODH NËSE NDRYSHON NDONJË ASPEKT I MBËSHTETJES?

Nëse autoritetet e Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare vendosin të kufizojnë ose anulojnë disa lloje mbështetjeje të marra nga një anëtar i familjes për shkak të një situatë siç shpjegohet në faqen 13, ai anëtar i familjes do të vazhdojë të marrë ndihmë bazuar në situatën dhe nevojat e tij personale. Ai do të jetë ende në gjendje të vizitohet nga një mjek ose një infermiere, të marrë ndihmë mjekësore, njëfarë mbështetjeje si ushqim dhe një vend për të fjetur në një vend të vendosur nga autoritetet.



Kur autoritetet vendosin të anulojnë mbështetjen që ofrohet për ju dhe familjen tuaj gjatë pritjes për shkak se ju jeni larguar drejt një vendi tjetër të BE+, lloji i mbështetjes që ju do të vazhdoni të përfitonit do të varet nga rrethanat dhe nevojat tuaja.

Ju do të vazhdoni të keni të drejtën për të frekuentuar shkollën.

TË DHËNAT E KONTAKTIT

Nëse ju dhe familja juaj keni pyetje apo keni nevojë për mbështetje gjatë qëndrimit tuaj, mund të bisedoni me stafin pranë:

autoritetit pritës



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration

Shërbimi i Akomodimit për Mbrojtje Ndërkombëtare
Departamenti i Drejtësisë, Çështjeve të Brendshme
dhe Migracionit.

51 St Stephen's Green, Dublin 2, D02 HK52

Email: IPASinbox@justice.ie

një autoriteti tjetër përkatës



An Oifig um Chosaint
Idirnáisiúnta
International Protection
Office

Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare

Departamenti i Drejtësisë, Punëve të Brendshme
dhe Migracionit

Faqja e internetit: <https://ipo.irishimmigration.ie>

një autoriteti tjetër përkatës



TUSLA – Agjencia e Fëmijëve dhe Familjes

Ndërtesa Brunel, Heuston South Quarter Saint John's
Road West, Dublin 8, D08 X01F

Faqja e internetit: [Tusla - Child and Family Agency](https://tusla.ie)

Ju mund të kontaktoni gjithashtu me këto organizata për pyetje në lidhje me:

mbështetjen mjekësore



Në një urgjencë mjekësore, telefononi 999 ose 112 dhe kërkonti një ambulancë.

Për mënyrën e vizitës te një mjek, flisni me përfaqësuesin tuaj.

Ata do t'ju ndihmojnë të regjistroheni te një mjek i përgjithshëm.

mbështetjen psikosociale



Kryqi i Kuq Irlandez ofron mbështetje për shëndetin mendor dhe mirëqenien për njerëzit që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Vizitoni faqen e tyre të [internetit](#) këtu për më shumë informacion.

Shërbimi HSE Cork dhe Kerry (shih [këtu](#) për informacion) ofron video online në arabisht dhe persisht rreth:

Traumës dhe PTSD

Menaxhimit të problemeve të gjumit

Ankthi

Shqetësimeve të tjera të shëndetit mendor.

Këshilli Irlandez i Refugjatëve ofron informacion rreth organizatave që mbështesin njerëzit që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë (shih [hartën](#)).

mbrojtjen e fëmijëve



Avokati i Popullit për Fëmijët
Millennium House, First Floor
52-56 Great Strand Street, Dublin 1, D01 F5P8

Faqja e internetit: [Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në Irlandë | Avokati i Popullit për Fëmijët \(oco.ie\)](#)

linjën telefonike për fëmijët në rrezik



Nëse ndiheni të lënë pas dore ose në rrezik, mund të telefononi falas në 119 ose 999.

Çdo fëmijë ose i ri mund të kontaktojë Childline duke telefonuar në 1800 66 66 66 ose duke biseduar online në [Childline.ie](#) 24 orë në ditë, çdo ditë.

Nëse vëllai, motra ose një mik juaj është zhdukur, mund të telefononi në Linjën e [Nxehhtë 116 000 - Fëmijët e Zhdukur në Evropë](#)

këshillimin, ndihmën dhe përfaqësimin ligjor



Këshillimi ligjor do t'ju vihet në dispozicion në Qendrën e Konventave Citywest në Shërbimin e Këshillimit Citywest të Bordit të Ndhmës Ligjore.

Ju mund të aplikoni për këshilla dhe përfaqësim ligjor (ndihmë ligjore) nga Bordi i Ndhmës Ligjore në Qendrën e Konventave Citywest ose në njërën nga këto 3 Qendra Ligjore:

Dublin: Qendra Ligjore Smithfield ☎ (01) 646 9600

Cork: Qendra Ligjore Popes Quay ☎ 087 945 1132

Galway: Qendra e Ndërmjetësimit Ligjor dhe Familjar në Galway ☎ 091 568 467 / 01 646 9637

Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)

që mbrojnë interesat dhe të drejtat e azilkërkuesve dhe refugjatëve.



Zyra e UNHCR-së në Irlandë ndodhet në Merrion House, Suite 4, 1-3 Lower Fitzwilliam Street, Dublin 2, Irlandë.

Faqja e internetit: <https://help.unhcr.org/>.

Email: iredunhcr.org

Telefon (Njësia e Mbrojtjes): +353 1 631 4613

Nëse keni një emergjencë mjekësore dhe jeni në rrezik, tregojuni menjëherë prindërve dhe stafit. në Qendrën tuaj të Akomodimit Ata do t'ju ndihmojnë!

Në rast se ju dhe familja juaj ndodheni jashtë vendit ku po qëndroni dhe keni ndonjë aksident ose jeni në rrezik, mund të telefononi falas këta numra urgjence:



urgjenca mjekësore: 112 / 999



policia: 112 / 999

Nëse nuk keni telefon, mund t'i kërkonit dikujt të telefonojë në numrin e urgjencës për ju.



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration

Kjo broshurë është vetëm për qëllime informuese. Ajo nuk krijon në vetvete të drejta apo detyrime. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ka siguruar strukturën kryesore të këtij materiali dhe riprodhimi dhe ndryshimi i kësaj broshure autorizohet nga EUAA vetëm për shtetet anëtare të BE-së. EUAA nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi apo detyrim për saktësinë, përmbajtjen, plotësinë, ligjshmërinë ose besueshmërinë e informacionit të përfshirë në këtë faqe nga shtetet anëtare të BE-së ose nga ndonjë palë tjetër e tretë përgjegjëse. EUAA dhe çdokush që vepron në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban kjo broshurë.